



Crna Gora / Mali i Zi  
Opština Ulcinj  
Komuna e Ulqinit  
Sekretarijati për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ekologji

Adresa: Bul. Skenderbega/Skenderbeu  
85360 Ulcinj/Ulqin, Crna Gora/Mali i Zi  
e-mail: [zecarije.sulejmanovic@ul-gov.me](mailto:zecarije.sulejmanovic@ul-gov.me)  
[agroul@ul-gov.me](mailto:agroul@ul-gov.me)  
[www.ul-gov.me](http://www.ul-gov.me)

Br./Nr. 17- 317/24-134/1

Ulcinj/Ulqin, 22.04.2024. god. vit

Sekretariati për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ekologji në bazë të nenit 42 të Vendimi për Masat Stimuluese për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural ("Fletorja zyrtare MZ-dispozitat komunale numër 17/2023, të datës 13.04.2023), në pajtushmëri me Buxhetin e Komunës së Ulqinit dhe me Planin e shfrytëzimit të mjeteve për mbështetje të zhvillimit të bujqësisë për vitin 2024 numër 01-082/23-777/2, shpall:

### THIRRJEN PUBLIKE

#### Për ndarjen e mjeteve mbështetëse për prodhim dhe zhvillim të ullishtarisë për vitin 2024

#### SUBJEKTI I THIRRJES

Në kuadër të masave mbështetëse për prodhim dhe zhvillim të ullishtarisë për vitin 2024, përfituesi realizon të drejtën e mjeteve mbështetëse për investime që kanë të bëjnë me mbjelljem e ullishtave të reja dhe blerjen e paisjeve për zhvillim të ullishtarisë.

#### PËRKUFIZIMI I PËRDORËSVE TË MBËSHTETJEVE

Të drejtën e mbështetjes sipas kësaj thirre publike kanë personat fizik dhe juridik. Personat fizik duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e amvisërive bujqësore dhe në Regjistrin e prodhuesve të ullinjëve ose/dhe Regjistrin e prodhuesve të vajit të ullirit, në përputhje me Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural („Fl. Zyrtare e MZ“, numër. 56/09, 34/14, 1/15, 30/17, 51/2017 dhe 59/2021). Nëse dorëzuesit e kërkesës janë persona juridik veprimtaria e tyre primare duhet të jetë nga sektori A: bujqësia, pylltaria, peshkimi, në pajtushmëri me Ligjin për klasifikim të veprimtarive („Fl. Zyrtare e MZ“, numër. 152/22). Dorëzuesi i kërkesës duhet të ketë vendbanimin, gjegjësisht selinë në territorin e komunës së Ulqinit dhe veprimtarinë bujqësore ta ushtrojë në komunën e Ulqinit.

#### INVESTIMET E PRANUESHME

Investimet që mbështeten me këtë thirrje janë:

- Furnizimi me fidane për ullishta të reja;
- Blerja e mekanizimit dhe paisjeve për vjelje dhe mirëmbajtje të ullinjëve (shkundëse, rrjetat për vjelje, kosat për mirëmbajtje të ullishtës, bluarë të degëve, paisjet për krastitje, pajisje për deponimin e vajit të ullirit- enë inox, paketim xhami i errët);
- Blerja e sistemeve të ujitjes (pompa, gypa ujësjellësi, gypa shpërndarës, lidhës etj.);
- Rivitalizimi i ullinjve të vjetër
- Blerja e mjeteve adekuate për aplikimin e masave agroteknike për ushqimin dhe mbrojtjen e bimëve
- Analiza laboratorike e produkteve të gatshme dhe/ose analiza laboratorike e tokës.

#### SHUMA E MBËSHTETJES

Për të gjitha mbështetjet e përmendura, sipas Planit të përdorimit të mjeteve janë të dedikuara gjithsej **28.000,00€** për vitin 2024.

Shuma e mbështetjes është 50 %, nga shpenzimet totale të pranueshme të investimit. Një shtesë prej 10%, ose 60%, arrihet nga gratë dhe të rinjtë si pronarë të amvisërive bujqësore.

Përdoruesit mund të marrin një shumë maksimale të mbështetjes deri në **700,00 €**.

Mbështetja realizohet në përfundim të investimit pas kontrollit administrativ dhe kontrollit në vend.



## **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË PRANUESHMËRISË**

Të drejtën për mbështetje shfrytëzuesi mund ta realizojë nëse:

- i plotëson të gjitha kushtet sipas Vendimit për masat stimuluese për zhvillim bujqësor dhe rural;
- nuk ka obligime tatimore të pashlyera ndaj administratës lokale;
- për të njëjtin investim nuk ka marr mjete nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ujërave.

Me këto masa **nuk mbështetet**:

- blerja e paisjeve dhe mekanizimit të përdorur,
- blerja e fidaneve hortikulturore (dekorative)
- shpenzimet tatimore, doganore, importi, taksat administrative dhe të ngjashme,
- blerja ose marrja me qira e tokës bujqësore dhe objekteve ekzistuese,
- shpenzimet e mjeteve qarkulluese dhe shpenzimet operative,
- shpenzimet e punës së vet (pagat, kontributet).

## **KRITERET SPECIFIKE TË PRANUESHMËRISË**

Shfrytëzuesi duhet të ketë në pronësi më së paku 2000 m<sup>2</sup> tokë bujqësore ose të posedojë më shumë se 50 rrënjë ullinj.

Nëse investimi bëhet për blerjen e paisjeve për përpunimin e ullinjëve, për mbështetje të pranueshëm janë prodhuesit bujqësor që kanë minimum 50 rrënjë ullinj frytdhënës.

Nëse investimi bëhet për blerjen e fidaneve minimumi duhet të jetë 20 fidanë dhe kërkesa duhet të shoqërohet më deklaratën e kualitetit të fidaneve. Deri në momentin e pagesës së mjeteve mbështetëse për ullishtë të re ajo duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e amvisërive bujqësore.

Nëse investimi bëhet për ndërtimin e sistemeve të ujitjes, shfrytëzuesi si dëshmi duhet të dorëzojë edhe fakturën për blerjen e materialit.

Numri maksimal i ullinjve për rivitalizim është 25 ullinj, dhe shuma e mbështetjes për ulli është 10€;

## **DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:**

- Kërkesa për pranimin e mbështetjes/investimin;
- Vendimi i regjistrimit të amvisërisë bujqësore që e lëshon Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ujërave (numri ID i amvisërisë);
- Vendimi nga Regjistri i prodhuesve të ullinjëve dhe/ose Regjistri i prodhuesve të vajit të ullirit;
- Për persona juridik ekstrati nga CRPS, (regjistri qendror për subjete ekonomike) ;
- Vërtetimin e pronësisë ose përdorimit të tokës (certifikatë pronësie jo më e vjetër se 6 muaj, marrëveshje qiraje ose kopje e regjistrimit të parcelave pranë Shërbimit Këshillimor Rajonal)
- Fotokopia e letërnjoftimët të dorëzuesit të kërkesës;
- Vërtetimi se aplikanti nuk ka obligime tatimore ndaj organeve të admin. lokale;
- Kopia e fletëgarancisë për paisjen e blerë
- Dëshmia se paisja është paguar në formën e:
  - faturës fiskale me dëshmi pranimi me emrin e blerësit;
  - në rastin e pagesës përmes xhiro-llogarisë (pagesat llogaritare) udhër-pagesa e vërtetuar (e pagesës) për transferin e mjeteve shitësit dhe fatura e verifikuar;
  - dëshmit tjera specifike të parapara me kriteret specifike të pranueshmërisë.

## **SI TË DËRGO NI KËRKESËN**

Formulari i Kërkesës për mbështetje për prodhim dhe zhvillim të ullishtarisë për vitin 2024 mund ta merrni në zyrën e Sekretariatit për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ekologji si dhe në Byronë e qytetarëve të Komunës së Ulqinit.

Formularin e plotësuar të kërkesës dhe dokumentacionin përcjellës dërgohet në Byronë e qytetarëve të Komunës së Ulqinit apo me postë në adresën:



**Sekretariatit për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe  
Ekologji**  
**Kërkes sipas Thirrjes publike për ndarjen e  
mjeteve mbështetëse për prodhim dhe zhvillim të  
ullishtarisë për vitin 2024**

**Bulevardi Skenderbeg,  
85360 Ulcinj**

**Afati i dërgimit të kërkesës** është deri më **01 nëntor 2024**, gjegjësisht deri në shpenzimin e mjeteve të dedikuara për realizimin e këtij programi.

Nëse mjetet shpenzohen para datës 01 nëntor 2024, Thirrja publike do të mbyllet për çka do të informohen prodhuesit.

**PROCEDURA E REALIZIMIT**

Sekretariati do të vizitojë prodhuesit që kanë dorëzuar dokumentacionin, para se të lejohet mbështetja financiare, për të bërë verifikimin në vend të të dhënave dhe kushteve të parapara me Vendimin për masat stimuluese për bujqësi dhe zhvillim rural dhe me këtë Thirrje, dhe për këte bënë procesverbalin me vlerësim dhe mendim për plotësimin e kushteve për përfitimin e mjeteve mbështetëse financiare.

Nëse shfrytëzuesi nuk lejon ose ndalon punën e Sekretariatit në terren, ose në ndonjë mënyrë tjetër ndikon në punën e tij, Kërkesa e shfrytëzuesit do të refuzohet.

Në bazë të dokumentacionit të dërguar dhe shqyrtimit në vend Sekretariati konstaton a janë të plotësuar kushtet për realizimin e të drejtës për mjete dhe me aktvendim lejon pagesën e mjeteve mbështetëse financiare.

Shfrytëzuesit duhet t'i shpenzojnë mjetet mbështetëse për atë që janë dedikuar dhe nuk mund t'i tjetërsojnë ata, ose t'i japin diku tjetër për përdorim investimin sipas kësaj kërkesë, në periudhën 5 vjeçare prej ditës së përfitimit.

Kontrolin e shpenzimit të mjeteve të lejuara për mbështetje në kontinuitet do ta ushtrojë organi kompetent për punët e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Shfrytëzuesit që përdorin mbështetjen për qëllime jo të synuara, me vendim të organit kompetent, humbasin të drejtën e mbështetjes për çka Sekretariati nxjerr vendim të posaçëm me të cilin urdhërohet përfituesi të kthej mjetet.

Në këtë rast, përfituesi obligohet të kthej mjetet e përfituara plotësisht në afatin prej 30 ditëve prej marrjes së vendimit.

Personat që kanë dhanë të dhëna jo të sakta në kërkesën e tyre, e të cilat i konstaton organi kompetent, nuk kanë të drejtë në masat mbështetëse.

Përfituesit duhet të ruajnë dokumentacionin në bazë të së cilët kanë fituar të drejtën për masën mbështetëse, më së paku pesë vjetë prej ditës së marrjes së mjeteve mbështetëse. Aplikanti kërkesa e të cilit refuzohet do të lajmërohet për shkaqet e refuzimit. Normat ndëshkuese janë të normuara në nenin 49 dhe 50 të Vendimit për masat mbështetëse për zhvillim bujqësor dhe rural.

**VËREJTJE:**

Kërkesat e arritura pas afatit Sekretariati nuk do ti shqyrtojë.

Sekretariati do të pranoj si të vlefshme faturat e vitit 2024 deri në datën e skadimit të afatit të thirrjes publike (01.11.2024).

Informatat në lidhje me Thirrjen publike mund të merren në e-mail [agroul@ul-qov.me](mailto:agroul@ul-qov.me) ose personalisht në zyrën e Sekretariatit për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ekologji.